

# Udhëzime për aplikuesit në grante

Afati për dorëzim: 01 nëntor 2018

Project implemented by:

**volkshilfe.**  
SOLIDARITÄT



**NSHC**  
KOVÇARSHI HUMANITARIANË ÇEKIAE



WITH FUNDING FROM

**AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION**

<b>1. HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>2. ALOKIMET FINANCIARE</b>	<b>3</b>
<b>3. PRANUESHMËRIA</b>	<b>4</b>
3.1. Pranueshmëria e aplikuesve .....	4
3.2. Pranueshmëria e veprimeve.....	4
<b>4. KRITERET E PËRZGJEDHJES</b>	<b>6</b>
<b>5. MBIKËQYRJA DHE MBËSHTETJA PËR PËRFITUESIT</b>	<b>8</b>
<b>6. DISPOZITAT FINANCIARE</b>	<b>8</b>
6.1. Shpenzimet e pranueshme .....	8
6.2. Shpenzimet e pranueshmedirekte.....	9
6.3. Shpenzimet e papranueshme .....	9
<b>7. KONTRATA</b>	<b>10</b>
<b>8. RAPORTIMI</b>	<b>10</b>
<b>9. PUBLICITETI</b>	<b>10</b>
<b>10.DORËZIMI I PROPOZIMEVE</b>	<b>11</b>

Project implemented by:






WITH FUNDING FROM

**AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION**

## 1. Hyrje

Kjo thirrje bëhet nga “**SEED faza e dytë Kosova–Mbështetje për Zhvillimin e Arsimit dhe Punësimit në Kosovë**”, një projekt i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim i zbatuar nga **OJQ Syri i Vizionit** dhe **Volkshilfe Solidarität**. Synimi i kësaj thirrje është të përmirësojë cilësinë e arsimit për sa i përket orientimit të biznesit dhe/apo uljes së pengesave për karrierat e grave në sektor.

Projekti SEED faza e dytë Kosova ka filluar në janar të vitit 2017 dhe ai përfshin një varg të gjerë aktivitetesh të cilat do të zbatohen në një periudhë trevjeçare.

Thirrja e tanishme përmban tri pjesë. Propozimet në kuadër të kësaj thirrje mund të dorëzohen në tri fushat vijuese:

**Pjesa 1: Zhvillimi i një sistemi për përditësimin e plan-programeve të shkollave të mesme profesionale – drejtimi i hotelerisë dhe turizmit (HT) sipas nevojave të tregut**

**Pjesa 2: Zhvillimi i një sistemi efektiv të praktikave profesionale në mënyrë që nxënësit e shkollave të mesme - drejtimi HT të pajisen me aftësi praktike**

**Pjesa 3: Rritja e numrit të femrave në sektorin e hotelerisë dhe turizmit në zonën e përfshirë**

## 2. Alokimet financiare

Shuma e përgjithshme treguese e cila është vënë në dispozicion nën këtë thirrje për propozime është 43,000.00 Euro. Autoriteti Kontraktues mban të drejtën të mos shpërblejë të gjitha fondet e vëna në dispozicion.

Në rast se alokimi i shënuar për njërën nga pjesët e veçanta nuk mund të shfrytëzohet për shkak të cilësisë së pamjaftueshme apo numrit të propozimeve të pranuar, SEED Kosova mban të drejtën t'i ri-alokojë fondet e mbetura tek një pjesë tjetër.

### Shuma e granteve

Çfarëdo granti që kërkohet në kuadër të kësaj thirrjeje për propozime duhet të bjerë në mes të shumave vijuese [minimale dhe] maksimale:

- **shuma minimale: 2,000.00 Euro**
- **shuma maksimale: 5,000.00 Euro**

Aplikuesit mund të dorëzojnë më shumë se një aplikacion për pjesë. Aplikuesi nuk mund të shpërblehet më shumë se 1 grant për pjesë në kuadër të kësaj Thirrje për Propozime.

"SEED Kosova" ia rezervon vetes mundësinë që të mos alokojë të gjitha fondet e vëna në dispozicion në rast se veprimet e propozuara nuk i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes.

Project implemented by:

## 3. Pranueshmëria

### 3.1. Pranueshmëria e aplikuesve

Në mënyrë që të jetë i pranueshëm për një grant, aplikuesi duhet të jetë:

- Organ **publik apo privat** i themeluar ligjshëm në Kosovë, OJQ-të, Shkollat e Mesme Profesionale në Pejë, Prizren dhe Gjakovë (profili i turizmit dhe hotelerisë), biznes në sektorin e hotelerisë dhe turizmit, shoqata apo operatorë tjerë turistik ose organizata të shoqërisë civile, apo
- **Grupe joformale apo ekspertë individual** ë cilët janë të bazuar në Kosovë.

Kushtet tjera:

- Veprimtaria parësore e aplikuesve duhet të jetë në sektorin e turizmit dhe hotelerisë apo/edhe në sektor të ndërlidhur me të
- Aplikuesit duhet që drejtpërsëdrejti të janë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e veprimit me partnerët e tyre, duke mos u sjellë si një ndërmjetës;
- Subjektet fitimprurëse janë të pranueshme në kuadër të kësaj thirrje për aplikacione;

### 3.2. Pranueshmëria e veprimeve

#### Kohëzgjatja

Veprimi duhet të ndodhë në mes të muajit dhjetor të vitit 2018 dhe shtatorit të vitit 2019

#### Lloji i veprimit

Projektet duhet të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit sa i përket orientimit të biznesit dhe/apo uljes së pengesave për karrierat e grave në sektor. Projektet e propozuara duhet t'u kontribuojnë objektivave të njëjës nga tri fushat e intervenimit.

**Pjesa 1:** Prioritet do t'u jepet atyre projekteve të cilat konkretisht ndikojnë në lidhjen e shkollave të mesme profesionale (drejtimin të hotelerisë dhe turizmit të shkollave të mesme ekonomike në Gjakovë, Pejë e Prizren) me bizneset e këtij sektori, në veçanti për kompletimin e praktikës së nxënësve të këtij drejtimi në bizneset ekzistuese. Aktivitetet mund të përfshijnë:

- Përmirësimin/krijimin e sistemit të praktikave. Të krijohet një sistem për kompletimin e praktikave të nxënësve të cilët vijojnë drejtimet për hoteleri e turizëm në shkollat e mesme ekonomike të Gjakovës, Prizrenit e Pejës, në bizneset ekzistuese
- Ndërtimi dhe funksionalizimi i kabineteve për përfundimin e praktikave për hotelieri dhe turizëm në shkollat e mesme ekonomike profesionale në Pejë, Gjakovë dhe Prizren
- Angazhimi dhe certifikimi i studentëve nga bizneset ose organizatat turistike për punë vullnetare dhe praktika gjatë pushimeve
- Ndërtim kapacitetesh të mësimdhënësve në shkollat e mesme profesionale dhe/apo përfaqësuesve të bizneseve në temat të cilat ndërlidhen me biznesin
- Ligjërata të përfaqësuesve të biznesit nga sektori i hotelerisë dhe turizmit në shkollat e mesme profesionale (drejtimi hotelieri dhe turizëm i shkollave të mesme ekonomike në Gjakovë, Pejë e Prizren)
- Angazhimi i përfaqësuesve të biznesit në sistemin e kualifikimit (vlerësimit).

Project implemented by:



WITH FUNDING FROM

AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

**Pjesa 2:** Plan-programet ekzistuese janë vlerësuar si të vjetërsuara, përderisa ato janë duke munguar tërësisht për disa profile të rëndësishme profesionale të industrisë. Prandaj, SEED mbështet nismat të cilat sjellin tek rishikimi i plan-programeve ekzistuese dhe elaborimin e të rejave. Nismat e tilla mund të përfshijnë:

- Zhvillimin e aftësive të përfaqësuesve të shkollave dhe bizneseve në fushën e krijimit të plan-programeve
- Vlerësimin e nevojave në industri për aftësitë e nevojshme të mësuara në shkollën profesionale
- Elaborimin e propozimeve të plan-programeve të bazuara vlerësimin e nevojave të industrisë
- Lobimin tek autoritetet vendimmarrëse

**Pjesa 3:** Numri i studenteve në industrinë e hotelarisë dhe turizmit është i vogël. Numri i grave të angazhuara në sektor është po ashtu i vogël. Studimi për barrierat gjinore [https://syriivizionit.org/repository/docs/20151119085550\\_Barrierat\\_E\\_femrave\\_ne\\_sektorin\\_e\\_turizmit\\_SiV\\_UBO.pdf](https://syriivizionit.org/repository/docs/20151119085550_Barrierat_E_femrave_ne_sektorin_e_turizmit_SiV_UBO.pdf) i kryer në kuadër të projektit SEED ka identifikuar barrierat kulturore e ligjore (mbrojtje të pamjaftueshme të të punësuarave sa i përket pushimit të lehonisë, etj.) Projektet në këtë fushë të intervenimit duhet të kontribuojnë në tejkalimin e barrierave të vlerësuar, p.sh.

- Fushata promovimi nga përfaqësuesit e sektorit (shkollat apo/edhe bizneset)
- Fushata vetëdijesimi nga grupet e interesit me objektiv të përfshirjes së më shumë grave në industrinë e hotelarisë dhe turizmit
- Programe stimulimi për të tërhequr më shumë nxënës
- Programe trajnimi dhe edukimi veçanërisht për gratë e angazhuara në industri

**Llojet vijuese të veprimit nuk do të janë të pranueshme për financim:**

- Ngjarjet të karakterit të pastër religjioz apo politik;
- Veprimet që kanë të bëjnë me sponsorim për seminare, konferenca, kongrese;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm apo kryesisht me bursat individuale për studime, kërkime apo kurse trajnimi;
- Borxhe dhe obligime;
- Veprimet të cilat ekskluzivisht apo para së gjithash përbëhen nga shpenzimi kapital, siç janë infrastruktura, toka, pajisjet;
- Veprimet të cilat kanë për qëllim të ngritin fonde apo të promovojnë dukshmërinë e aplikuesit apo partnerit/partnerëve të tij;
- Veprime të cilat drejtpërsëdrejti mbështesin partitë politike.

### 3.3. Mbrojtja e kriterëve mjedisore dhe shoqërore

Për të siguruar që ndikimet negative të projekteve të mbështetura të shmangen, kriteret dhe mbrojtjet mjedisore e ato shoqërore duhet të merren parasysh në aplikimet dhe aktivitetet e projektit. Kriteret e tilla po ashtu përfshihen në vlerësim. Programet e propozuara duhet të marrin parasysh mbrojtjen e kriterëve mjedisore dhe shoqërore dhe "Listën e Përrjashtimit" të cilat janë paraparë në Doracakun për Menaxhimin e Ndikimit Mjedisor, Gjinator dhe Shoqëror nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Doracakun,

Project implemented by:

mund ta gjeni në lidhjen e mëposhtme të internetit:

[https://www.entwicklung.at/fileadmin/user\\_upload/Dokumente/Publikationen/Handbuecher/Environmental\\_and\\_Social\\_Impact\\_Management/EGSIM\\_Manual\\_Juni2018.pdf](https://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Dokumente/Publikationen/Handbuecher/Environmental_and_Social_Impact_Management/EGSIM_Manual_Juni2018.pdf)

## 4. Kriteret e përzgjedhjes

Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga juria e cila do të nominohet për vlerësimin e të gjitha aplikacioneve të dorëzuara. Të gjitha aplikacionet do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve vijuese.

Në rast se kontrollimi i aplikacionit gjen se veprimi i propozuar nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të deklaruar, atëherë aplikacioni do të refuzohet vetëm mbi këtë bazë

### 4.1 Hapi 1. Kontrollat administrative dhe vlerësimi i idesë së projektit

Gjërat vijuese do të vlerësohen gjatë kontrollit administrativ:

- Nëse afati është respektuar. Përndryshe, aplikacioni do të refuzohet automatikisht.
- Nëse ndonjëra nga informatat e kërkuara do të mungojë apo do të jetë e pasaktë, aplikacioni mund të refuzohet vetëm mbi këtë bazë dhe aplikacioni nuk do vlerësohet më tej.

### 4.2 Hapi 2. Vlerësimi i aplikacionit të plotë

Pikësëpari, gjërat do të vlerësohen si në vijim:

- Në rast se afati i dorëzimit është respektuar. Përndryshe, aplikacioni do të refuzohet automatikisht.
- Nëse ndonjëra nga informatat e kërkuara do të mungojë apo do të jetë e pasaktë, aplikacioni mund të refuzohet vetëm mbi këtë bazë dhe aplikacioni nuk do vlerësohet më tej.

Aplikacionet/projektet e pranueshme do të vlerësohen në bazë të kriterëve vijuese:

Project implemented by:



WITH FUNDING FROM

AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

	Kriteret	Definicioni	Koeficienti Maks.
1.	Rëndësia e veprimit	<p>Ky kriter vlerëson rëndësinë e përmbajtjes së veprimit kundrejt objektivave të thirrjes për propozime dhe nevojave të sektorit të hotelerisë e turizmit dhe grupeve të synuara (formati, realizueshmëria dhe përputhja e veprim në relacion me objektivat)</p> <p>Kriteri po ashtu vlerëson se sa qartazi e në çfarë mënyre strategjike janë zgjedhur ata që janë të përfshirë (përfituesit përfundimtarë, partnerët vendorë, grupet e synuara) dhe si janë përcaktuar e adresuar nevojat e tyre.</p>	30
2.	Dizajni i veprimit	<p>Ky kriter vlerëson se sa i kuptueshëm është dizajni i përgjithshëm i veprimit? Posaçërisht, a e pasqyron ai analizimin e problemeve të përfshira, a i merr parasysh faktorët e jashtëm dhe akterët relevant dhe a është veprimi i realizueshëm e i përputhshëm në raport me objektivat dhe rezultatet e pritura?</p>	20
3.	Qëndrueshmëria e veprimit	<p>A ka gjasa që veprimi të ketë një ndikim të prekshëm në grupet e synuara të tij? A ka gjasa që propozimi të ketë efekte shumëzuese? A janë rezultatet e pritura të veprimit të propozuar të qëndrueshme? Financiarisht (si do të financohen aktivitetet pasi që të përfundojë financimi?), institucionalisht (a do të janë strukturat që i mundësojnë aktivitetet të vazhdojnë të janë në funksion në fund të veprimit? A do të ketë 'pronësi' vendore të rezultateve të veprimit?), në nivel politikash (aty ku është e zbatueshme) (çfarë do të jetë ndikimi strukturor i veprimit — p.sh. a do të sjellë deri tek legjislacioni i përmirësuar, kodet e mirësjelljes, metodat, etj.?)</p>	20

Project implemented by:






WITH FUNDING FROM

AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION

4.	Cilësia e ofertës financiare	Kriteri vlerëson buxhetin dhe përpjesëtimin në mes të shpenzimeve të vlerësuara dhe veprimit të propozuar si dhe shpenzimeve reale.	10
5.	Potenciali i ekipit të projektit	Kriteri vlerëson potencialin e projektit duke vlerësuar cilësinë dhe strukturën e ekipit të projektit.	10
6.	Përvoja e mëhershme	Kriteri vlerëson ekspertizën e aplikuesit në fushën që lidhet me veprimin për të siguruar cilësinë e mirë të rezultateve.	10

Aplikacionet do të vlerësohen në një shkallë prej 0 deri në 100 dhe do të radhiten sipas meritës së tyre. Pragu është përcaktuar në **70/100 pikë**. Aplikacionet që cilat marrin mbi 70 pikë do të konsiderohen si aplikacione të suksesshme. Ato do të renditen nga pikat më të larta të marra deri në shpenzim të fondit prej 43.000.00 eurosh.

## 5. Mbikëqyrja dhe mbështetja për përfituesit

Të gjitha aplikacionet të cilat përzgjidhen programi SEED faza e dytë Kosova, do të ftojë aplikuesit në një takim konsultativ.

Ekipi i projektit të SEED faza e dytë Kosova, do të ofrojë një ndihmesë për përfituesit në çështjet si menaxhimi, marketingu, shpërndarja, ngritja e fondeve, krijimi i audiencës, etj., për të siguruar zbatimin e drejtë të projekteve si dhe zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tyre të ardhme.

## 6. Dispozitat financiare

Financimi do të mbulojë maksimum 100% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

### 6.1. Shpenzimet e pranueshme

Vetëm "shpenzimet e pranueshme" mund të mbulohen nga një grant. Kategoritë e shpenzimeve të pranueshme dhe të papranueshme janë shënuar më poshtë.

Shpenzimet e pranueshme janë shpenzime të cilat janë bërë në të vërtetë nga përfituesi i një granti të cilat i plotësojnë kriteret në vijim:

- Ato janë bërë gjatë kohëzgjatjes së veprimit;
- Ato janë shënuar në buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar;
- Ato janë bërë në lidhje me veprimin i cili është lëndë e grantit dhe janë të domosdoshme për zbatimin e veprimit;

Project implemented by:



WITH FUNDING FROM

AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION



- Ato janë të identifikueshme dhe të vërtetueshme, veçanërisht duke qenë të regjistruara në regjistrat e mbajtje së llogarive të përfituesit dhe të përcaktuara sipas standardeve të aplikueshme për mbajtje të llogarive të Kosovës dhe sipas praktikave të zakonshme të llogari-mbajtjes së shpenzimeve të përfituesit;
- Ato janë në pajtim me kërkesat për tatimin e zbatueshëm dhe legjislacionin social.

## 6.2. Shpenzimet e pranueshme direkte

Shpenzimet e pranueshme direkte për veprimin janë ato shpenzime të cilat, në lidhje të duhur të kushteve të pranueshmërisë të caktuara më lartë, janë të identifikueshme si shpenzime specifike të lidhura direkt me kryerjen e veprimit, siç janë:

- Shpenzimet për udhëtim dhe mjete jetese (për takime, konferenca, ngjarje, etj.);
- Pagesa profesionale për ekspertët e përfshirë të drejtpërsëdrejti në zbatimin e veprimit;
- Shpenzimet për mallrat shpenzuese dhe furnizimet, me kusht që ato të janë të identifikueshme dhe të përcaktuara për veprimin;
- Shpenzimet të cilat dalin direkt nga kërkesat të cilat lidhen me kryerjen e veprimit (shpërndarja e informatave, përkthimet, riprodhimi, shtypja dhe shpërndarja e fletushkave, etj.);
- Shpenzimet e qiramarrjes së vendtakimeve të cilat lidhen me kryerjen e veprimit.

Të paparashikuara deri në 5% të buxhetit të përgjithshëm të cilat kërkojnë miratim paraprak:

Në rast se përfituesi mund të kërkojë kalim të TVSH-së atëherë artikujt e shpenzimit të buxhetit nuk duhet të përfshijnë TVSH-në.

Në rast se përfituesi nuk mund të kërkojë kalim të TVSH-së atëherë artikujt e shpenzimit të buxhetit duhet të përfshijnë TVSH-në.

## 6.3. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet në vijim nuk janë të pranueshme:

- Borxhet dhe ngarkesat e shërbimit për borxhe (interesi);
- Dispozitat për humbjet apo përgjegjësitë potenciale të ardhshme;
- Blerjet e tokave apo ndërtesave;
- Blerja e makinave;
- Qiraja për zyre, përveç nëse aplikuesi mund të dëshmojë se marrja me qira e zyrës shtesë dhe të veçantë është e domosdoshme për qëllime të zbatimit të veprimit;
- Humbjet e këmbimit të parave;
- Tatimet, përfshirë edhe TVSH-në, përveç nëse përfituesi dhe bashkë-përfituesit mund të dëshmojnë se nuk mund t'i ri-kërkojnë ato;
- Krediti për palët e treta.

Project implemented by:

**volkshilfe.**  
SOLIDARITÄT



**NSHC**  
NONOJADRIE HUMANITARI NE COKRAE



WITH FUNDING FROM

**AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION**

## 7. Kontrata

OJQ Syri i Vizionit do të nënshkruajë një kontratë me përfituesin i cili do të përfshijë informata për aktivitetet të cilat do të zbatohen, vlerën e kontratës, modalitetet e pagesës dhe raportimin.

Pagesa e parë e para-financimit, e cila mbulon 50% të shumës së grantit, do të bëhet pas nënshkrimit të kontratës nga të dyja palët. Pagesa e transferit të dytë(40%) do të bëhet pasi që të dorëzohet raporti afatmesëm narrativ dhe financiar.

10% e mbetur do të paguhet pas miratimit nga ana e Syri i Vizionit të raportit përfundimtar të dorëzuar nga përfituesi.

## 8. Raportimi

Nga përfituesi do të kërkohet të dorëzojë raport afatmesëm narrativ dhe financiar. Raporti përfundimtar jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit të zbatimit të veprimit. Raporti përfundimtar duhet të përfshijë:

- Përmbledhjen ekzekutive: në jo më shumë 3 faqe, ajo paraqet një përmbledhje të konkluzioneve kryesore të vlerësimit, dëshmitë kryesore të cilat i mbështesin ato dhe rekomandimet që dalin nga to.
- Pjesa financiare: përfshin hollësi për shpenzimet (origjinalet e të gjitha faturave dhe prokurimin).
- Anekset: dokumentet të cilat mund të vërtetojnë zbatimin e veprimit siç janë publikimet, materialet e komunikimit, fotografitë, listat e pjesëmarrësve, etj.

## 9. Publiciteti

Përfituesit duhet të njohin kontributin e fondeve të ADA-s në të gjitha publikimet, afishet, programet, materialet audio-vizuale, praninë on-line dhe media sociale ose produkte tjera për të cilat shfrytëzohet financimi.

Në këtë aspekt, logot e Syri i Vizionit, Volkshilfe Solidarität ajo e Agjencisë Austriake për Zhvillim si dhe vërejtjet për mohim të përgjegjësisë të cilat do të shfrytëzohen do t'u ofrohen aplikuesve të suksesshëm nga ekipi i projektit i Syri i Vizionit.

Project implemented by:

## 10. Dorëzimi i propozimeve

Të gjithë aplikuesit e interesuar, mund ti shkarkojnë formën e aplikimit dhe të gjitha dokumentet tjera të nevojshme në: [www.syriivizionit.org](http://www.syriivizionit.org)

Projekt propozimet duhet të dërgohen në formë elektronike në adresën e e-mailit: [info@syriivizionit.org](mailto:info@syriivizionit.org) apo/edhe në shërbimit e regjistruar postar tek:

**“Syri i Vizionit”  
Isa Demaj 14  
30000, Pejë, Kosovë**

**Afati i fundit:** Projekt propozimi duhet të arrijë më së voni deri më **01 Nëntor 2018**.


Aplikacioni mund të shkruhet në shqip, anglisht apo serbisht.

Në momentin që afati i fundit për dorëzim të ketë kaluar, nuk do të lejohen kurrfarë modifikimesh të idesë së projektit. Megjithatë, nëse ekziston nevoja për sqarim të aspekteve të caktuara apo për korrigjim të gabimeve të zyrës, komisioni vlerësues mund të kontaktojë aplikuesin për këtë qëllim gjatë procesit të vlerësimit.

Çfarëdo pyetje e cila lidhet me përgatitjen e aplikacionit mund të dërgohet me e-mail deri më **24 tetor 2018** në adresën vijuese: [info@syriivizionit.org](mailto:info@syriivizionit.org)

Të gjithë aplikuesit do të njoftohen me e-mail në lidhje me rezultatet e procesit të përzgjedhjes **në mes të nëntorit 2018**.

Project implemented by:



WITH FUNDING FROM

**AUSTRIAN  
DEVELOPMENT  
COOPERATION**